

BASHKIA E TIRANËS

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE UNIFORMA DHE VESHJE TË TJERA SPECIALE
PËR POLICINË BASHKIAKE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Uniforma Policie
35811200-4**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **51,666,667 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.**

*** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 12/12/2024 është 98.22 Lekë/Euro.**

Burimi i financimit: Burimi i financimit: Vënë në dispozicion me anë të VKB-së Nr.125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024” (i ndryshuar).

Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: Nga data e nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Artikujt duhet të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Tiranë brenda 80 (tetëdhjetë) ditëve punë nga lidhja e kontratës.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se, referuar preventivit të artikujve, specifikimeve teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë, pasi do e bënte shumë të vështirë për t’u menaxhuar.

Kjo procedurë furnizimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik i cili do të shpallet fitues, pasi lloji i furnizimit për të qenë sa më efikas duhet të jetë i përqëndruar tek një operator ekonomik. Kryerja nga një operator ekonomik e bën më efektiv organizmin e punës por sidomos e bën shumë më të përshtatshëm monitorimin dhe raportimin e të gjitha proceseve të punës që kjo procedure ka.

Ndarja në lote do të sillte për pasojë ndikim në procedurë duke qenë se, njëri lot ndikon në lotin tjetër, pasi uniformat e Policisë Bashkiake janë një dhe e vetme. Kjo lloj uniforme është e miratuar me Vendim Këshilli Bashkak dhe është një e tërë duke nënkuptuar që një punonjës i Policisë Bashkiake pajiset me veshjen/ uniformën (Këmishë, xhakëtë, xhup, kapele perfshirë këpucët etj. aksesore dhe veshje pjesë e kësaj uniforme). Pra, nuk mund të zhvillohet në lote duke ndarë kështu zërat e artikujve, pasi ndarja në lote nënkupton dy procedura të ndryshme duke bërë kështu që nëse, një nga lotet do të ishte në proces ankimimi/ dështonte/ aullohej, nuk do të mund të kuptohej uniforma me veshjen “tekstile” (këmishë, xhakëtë etj) pa këpucët.

Ndarja në lote do të sillte konfuzion, pasi të gjithë zërat e kërkuar janë procese të lidhura ngushtë me njëra tjetrën dhe ndarja e tyre në lote do të sillte çrregullim në proces dhe vështirësi në monitorim të kryerjes së furnizimit, si dhe kosto shtesë për AK.

Për këtë arsye, është e pamundur që, artikujt e preventivit të ndahen në grupe ose veç e veç secili, pasi do të vështirësonte realizimin e kontratës, ndaj AK ka vendosur që këtë procedurë ta zhvillojë pa e ndarë në lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), neni 2 prashikohet shprehimisht se: "Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht:

"1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale".

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

"1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik".

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

"1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik”.

Në këto kushte, duke qenë se kemi të bëjmë me një familje artikujsh të vetëm dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se, realizimi i procedurës në një kontratë të pandarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre, në qarqe të ndryshme.

Në varësi të zërave që do të marrin përsipër të mbulojnë apo bashkimin e fuqisë punëtore dhe stafit, përcaktohet përqindja e pjesëmarrjes dhe elementët konkrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik e njih të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, për procedurën me objekt: **“Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake”.**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.*

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;". Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit 2021, 2022, 2023 të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gërmës "c" të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i*

ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

*Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se **40% e vlerës së përlogaritur të kontratës** që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si; referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 OFERTA TEKNIKE:

1. Skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, e lëshuar nga prodhuesi i tekstilit dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të artikujve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për artikujt/ Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodri postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

produktet që oferton.

2. Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. (Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndës së parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pika 6, gërma c), ku cilësohet se:

"Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike".

3. Artikujt në mënyrë që të përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN për veshjet/pajisjet mbrojtëse duhet të jenë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr. 425/2016. Për këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36, nenit 77 dhe nenit 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Në lidhje me këtë kriter, AK i është referuar një standarti ndërkombëtar, sikurse përcaktohet edhe në nenin 36 "Specifikimet teknike", të LPP-së, "...dhe kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve". Duke qenë se nuk ekziston një standart konkret kombëtar, pasi standartet e harmonizuara shqiptare të miratuara shërbejnë vetëm si dokumenta me karakter referues për prezumimin e konformitetit të produktit dhe i referohen direktivës 2016/425/EU, AK i referohet rregullores së re 2016/425/EU me anë të së cilës aplikohet për procedurë verifikimi dhe certifikimi të shoqërisë prodhuese, ku vlerësohet se në modelimin apo prodhimin e këtyre artikujve respektojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregulloren 2016/425/EU, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e personave. (referuar rregullores). Kërkesa, që artikujt objekt prokurimi të përmbushin kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr. 425/2016 është vendosur pasi këto veshje janë prodhim për përdorim pune nga punonjës institucioni në shërbim komuniteti dhe mbrojtje të jetës (pra jo përdorim personal), të cilët përballen me situatat të ndryshme vështirësie, përfshirë kushtet atmosferike që nuk janë të një natyre ekstreme apo kontakti me sipërfaqe të nxehta që nuk i kalojnë 50 gradë Celsius (referuar kategorive të vështirësisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016). Gjithashtu, AK në specifikimet teknike të përgatitura nga specialistë të fushës janë vendosur edhe standartet SSH/EN për artikujt përkatës.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, si pjesë të ofertës teknike fletë analizë të treguesve fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi dhe të kryer në laboratorët e akredituar.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 40, pika 6, gërma c) ku cilësohet se:

"Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike”.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, si pjesë të ofertës teknike mostrat/ kampionet e artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në DST në përputhje me specifikimet teknike, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik detyrimisht duhet të paraqesin nga një mostër fizike për objektet e uniformës (produkt të gatshëm) që do të prokurohen që përfshin të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike.

Shënim: Masa e kostumit për femra duhet të jetë 40, për meshkuj 52.

- b) Mostrat fizike të ndërtuara me lëndë të parë tekstil të jenë të shoqëruara me nga një pjesë 0,3-0,5 ml gjatësi lëndë të parë (tekstil sipas objekteve të uniformës) dhe sa gjerësia e vetë tekstilit në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit. Të dyja anët e tekstilit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt) dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.

Shënim: Tekstili që shoqëron mostrën: Veshjet janë prodhuar prej pëlhere qoftë kjo e ENDUR ose E THURUR, e ngjyrosur me një bojë solide, e printuar. Perpara prodhimit të veshjeve Porositësi duhet të kryejë teste për të kontrolluar konformitetin e specifikimeve teknike të produktit. Për kryerjen e këtyre testeve pranë Laboratorëve të Akredituar nevojiten 0.5 metra linear për tekstilet e endura edhe 0.3 metra linear për tekstilet e THURURA.

- c) Mostrat fizike si këpucet etj të ndërtuar me lëndë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 0,3X0,3cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike te tyre.
- d) Të gjitha detajet e mostrave (produkt të gatshëm) që do të paraqiten nga operatorët ekonomike të jenë të qepura me penj të kuq me tegela të definuar si duhet pa fije të dala.
- e) Mostrat e paraqitura duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të tabelave (psh: Nr.1- Xhup sintetik, referuar preventivit “Shtojca 3”/ shtojcës 7).
- f) Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Prokurimeve, Bashkia Tiranë, me adrese: Bulevardi ”Deshmoret e Kombit”, Tiranë. Mungesa e mostrës dhe e lëndës së parë që shoqëron ato është kusht s’kualifikues.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurave.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për

rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi., lidhur me të gjitha detajet, llojin e materialit dhe pjesëve të tyre, punimin dhe përmasat e caktuara në specifikimet teknike. Nëpërmjet mostarve të dorëzuara, Autoriteti Kontraktor mund të kryej kontrollin e mostrave të sjella me përputhshmërinë e specifikimeve të kërkuara dhe të kryejë analizat e nevojshme laboratorike nëse do e sheh të arsyeshme.

2.3.3. Ofertuesi duhet të paraqesin certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” për produktet tekstile (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit, nëse ofertuesi nuk është prodhues), për të vërtetuar se produktet e ofruara nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin (përfshi lëndën e parë dhe aksesorët: pëlhurë, astar, frazelinat, kopsat, butona, penj, zinxhir, zbukurime etj) dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të OEKO-TEX ose ekuivalente.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40 dhe nenit 44 të VKM-së Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizma kombëtarë i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Referuar specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, Njësia e Prokurimit gjykon se është e domosdoshme paraqitja e certifikatës OEKO-TEX, pasi është standarti që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën dhe është në përputhshmëri me rregulloren e Bashkimit Europian që synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të kimikateve (Registration, Evaluation, Authorization and Restriction of Chemicals –REACH), duke përfshirë kufizimet për substanca të caktuara të rrezikshme. Ky standart certifikon produktet, pasi janë të testuara për substanca të dëmshme duke siguruar që të jenë të sigurt dhe të mbrojnë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga kimikatet toksike.

Cdo komponent i një produkti që nga lënda e parë (metrazhi) e deri të aksesorët, duhet të jenë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i certifikatës është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar.

STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit.

Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Testi kryhet nga institutet partnere të pavarura OEKO-TEX® në bazë të katalogut të gjerë të kriterëve OEKO-TEX®.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues ose tregëtues i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Në rast se, ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave dhe të vërtetohet lidhja midis tyre. Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të ketë të përcaktuar të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, email, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se, ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim të mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

1- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

2- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se, çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e artikujve të sipërcituar, të njohë kapacitetet tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standartet e përcaktuara dhe duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/ distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015, ose ekuivalente për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;
- b) ISO 14001:2015, ose ekuivalente lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit
- c) ISO 45001:2018, ose ekuivalente lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në Punë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar,

Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”, si dhe në mbështetje të nenit 79, pika 1, ku citohet si vijon: ”1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë...”

Gjithashtu bazuar edhe në neni 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Për vetë natyrën dhe rëndësinë e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që, operatorët si zbatues të kontratës, të kryejnë veprimtarinë në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve, reputacionit dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë. Konkretisht:

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë, e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqëndrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundësuar atë, për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;
- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) është standart ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për cdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se, cdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001, me qëllim që

veprimtaria e ushtruar nga ana e tij të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci më tepër, që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot, si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës objekt prokurimi. objekt prokurimi.

Këto kërkesa janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e furnizimit me mallin, objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës në funksion të përmbushjes me sukses të kontratës duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar në stafin e tij teknik, specialist të fushës me eksperiencë, si më poshtë:

- Të paktën një Inxhinier Tekstil për tre muajt e fundit
- Të paktën një Modelist për tre muajt e fundit

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Për Inxhinierin Tekstil

-Kopje të diplomës

-Kontratën e punës

-Kopje të librezës së punës

-Deklarimin e profilin të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

-Listëpagesat sipas formularit E-sig 025/a për periudhën e kërkuar.

Për punonjës të Modelist:

-Dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë) lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara, sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”;

-Kontratën e punës;

-Kopje të librezës së punës;

-Deklarimin e profilin të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

-Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën kohore.

Shënim: Kriteri 2.3.6 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu bazuar në VKM-në nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)” të rishikuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës,

Për këtë është kërkuar që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se për periudhën 3 mujore, kanë patur pjesë të stafit të tyre personel të kualifikuar, përkatësisht sipas kategorive të kërkuara. Kjo kërkesë synon të garantojë autoritetin kontraktor se, kapacitetet njerëzore janë pjesë e përvojës së operatorit ekonomik ofertues dhe si të tilla rrisin sigurinë për të përmbushur dhe zbatuar kontratën objekt prokurimi brenda afateve kohore të parashikuara dhe në cilësinë e kërkuar.

*Konkretisht, kërkesa për **inxhinierin e Tekstilit** lidhet me përgjegjësinë e tij në zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve dhe produkteve në industrinë tekstile. Inxhinieri përfshihet në të gjitha fazat e prodhimit të tekstileve, nga përpunimi i lëndëve të para deri në zhvillimin e produkteve të reja dhe përmirësimin e procesve ekzistuese. Gjithashtu, punojnë për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e produkteve tekstile.*

Inxhinieri i tekstilit mund të punojë në disa fusha, nga fabrikimi i pëlhurave dhe aksesoreve, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin, prodhimin e veshjeve në të gjitha proceset, kontrollin e cilësisë dhe menaxhimin profesional. Ai mund të përcaktojë materialet e papërpunuara që duhen përdorur për të krijuar pëlhurat e duhura dhe të kontaktojë furnitorët për të koordinuar këto materiale. Gjithashtu, gjatë proceseve të prodhimit, ai mund të vëzhgojë dhe të koordinojë me teknikët për të identifikuar mënyra që i bëjnë operacionet më efikase.

Një inxhinier tekstili mund të implementojë dhe mbikëqyrë proceset e kontrollit të cilësisë dhe konformitetin e tyre me specifikimet teknike të kërkuara. Ai bashkëpunon me grupe të tjera pune, si shitësit, marketingun dhe grupin e shpërndarjes së mallit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë vecoritë e produkteve të tekstilit dhe si t'i prezantojnë ato te klientët.

*Kërkesa për **Modelist** lidhet me përzgjedhjen dhe përshtatjen e produkteve për prodhim. Ai është përgjegjës për koordinimin e çdo detaji funksional ndërmjet porositësit dhe prodhuesit, duke organizuar dhe shpjeguar materialet dhe aksesoret e duhur për realizimin në përputhje me standartet e cilësisë.*

Modelisti është përgjegjës për porositjen e veshjeve, materialeve bazë dhe ndihmëse, duke ndihmuar kështu në zhvillimin dhe krijimin e një stili dhe dizajni tërheqës. Stilistët/modelistët janë gjithashtu përgjegjës për adaptimin e interesave të porositësit në stil, ngjyra dhe shije. Ata janë konsulentë dhe punojnë ngushtë me ekspertët dhe profesionistët e tjerë të sektorit kudo që lind nevoja. Ata konsultojnë dhe këshillojnë prodhuesin për çdo detaj teknik për realizimin e modeleve të kërkuara. Ata janë gjithashtu personat përgjegjës për marrjen e masave trupore të klientit dhe përshtatjen profesionale të urdhërit të porosisë tek prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar, autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si më lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Objekti i procedurës së prokurimit: “Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të uniformës së Policisë Bashkiake, pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomikë të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e uniformës së Policisë Bashkiake me anë të së cilës, ata përfaqësojnë institucionin e Bashkisë Tiranë. Specialisti i kërkuar është i nevojshëm për të asistuar stafin e AK që do të ketë për detyrë procesin e prodhimit/ qepjeve apo modifikimeve në rast se do të jetë e nevojshme të mallrave objekt prokurimi.

Kërkesa e AK për paraqitjen e listëpagesave sipas Formularit E-sig 025/a për 3 muajt e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B, shërben në vetvete si garanci paraprake për realizimin dhe zbatimin e kontratës përgjatë periudhës së sipërcituar, duke qenë se nuk ka një mënyrë tjetër për të vërtetuar disponibilitetin e stafit në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe gjatë kohës së zbatimit të saj.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër me anë të mjeteve të tij të bëjë furnizimin e mallit objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor me shpenzimet e tij.

Për kryerjen e transportit, duhet të disponojë të paktën 1 (një) mjet transporti tip furgon të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

Në rastet kur mjeti është në pronësi:

- Certifikatë pronësie;
- Dokument që vërteton regjistrimin e mjetit
- Leje Qarkullimi;
- Siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);
- Çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS);
- Taksa vjetore.

Në rastet kur mjeti është me qera:

- Kontratë Qeraje noteriale për gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- Çertifikatë pronësie; dokument që vërteton regjistrimin e mjetit
- Leje Qarkullimi;
- Siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);
- Çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS);
- Taksa vjetore.

Shënim: Kriteri 2.3.7 do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ku citohet si vijon: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë apo mund t’u vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Kërkesa për mjetin e mësipërm i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe janë të domosdoshme duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu, merret në konsideratë edhe fakti se, furnizimi me mallrat objekt prokurimi, nga operatori ekonomik fitues do të bëhet për të gjithë aparatën e Policisë Bashkiake. Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, referuar nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. Referuar nenit 82, pika 4 e ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, “Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë”, si dhe Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, “Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

3. “Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.”

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termet e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Shënim: Në kuptim të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar, pika 3/b, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Nëse ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN, mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024” (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake”**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në specifikimet teknike të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për çmimin e uniformave dhe aksesorëve shoqëruar, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën **“Uniforma dhe veshje të tjera special për Policinë Bashkiake”**.”

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, i ngritur urdhër të Titullarit të AK, Bashkia Tiranë,

në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave për materialet objekt prokurimi, në funksion të zhvillimit të detyrave të punonjësve të administratës, përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e furnizimit me këto materiale.

SPECIFIKIME TEKNIKE UNIFORMA E POL.BASHKIAKE

Baza ligjore: Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 162/2020 për “Prokurimin publik”, Ligjit nr. 89/2022 datë “Për Policinë Bashkiake”, VKM-së nr.494 datë 24.08.2023 “Për miratimin e uniformës, Shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të indentifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake”, VKM nr. 406 datë 19.06.2024 për një ndryshim në vendimin nr.494, datë 24.8.2023 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake” dhe VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024” (i ndryshuar); kërkojmë të fillojë procedura e prokurimit me objekt: “Blerje uniforma dhe veshje të tjera speciale” për Policinë Bashkiake, sipas specifikimeve dhe preventivit bashkëlidhur,

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit

NJËSIA E PROKURIMIT